

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6122
E enjte, 24 shtator 2020
çmimi 0.40 €

Imri Ahmeti zgjedhet kryetar i Asociacionit të Komunave të Kosovës



FAQE 7

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", HYSNI GUCATI | FAQE 4-5

SPECIALJA MË S'KA KREDIBILITET PËR DREJTËSI



Kryetari i Organizatës së Veteranëve i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Hysni Gucati, ka thënë se kredibiliteti i Gjykatës Speciale ka rënë përtokë. Në këtë intervistë dhënë

gazetës "Epoka e re", ai ka theksuar se pas rrjedhjes së mijëra dosjeve ky institucion nuk mund të vendosë më drejtësi. Gucati ka deklaruar se tani kjo gjykatë do të duhej të mbyllej.

Sipas tij, OVLUÇK-ja nuk është fajtorë pse Gjykatës Speciale i kanë dalë nga dora dokumentet. Gucati ka përsëritur se OVLUÇK-ja nuk është kundër drejtësisë

AKTUALE

KONSTITUOHET KUVENDI I MALIT TË ZI PA PRANINË E GJUKANOVIQIT F. 3

HOTI: TË SHFRYTËZOHET MOMENTUMI PAS NËNSHKRIMIT TË MARRËVESHJES NË UASHINGTON F. 3

NË 24 ORËT E FUNDIT, NJË PACIENT I VDEKUR, 62 TË INFEKTUAR ME COVID NË KOSOVË F. 7

EKONOMI

KËRKOHEM MË SHUMË PROFESIONALIZËM NË MENAXHIMIN E KOMPANIVE PUBLIKE TË UJËRAVE F. 9

PËR 'MINIERËN E RE' TË KEK-ut, XHEMAJLI: QEVERIA PO ABUZON QINDRA MILIONA EURO TË SHTETIT F. 8

KULTURË

PËRFUNDOJNË PUNIMET PËR RESTAURIMIN E HAMBARIT TË FAMILJES JONUJAZ NË FSHATIN SENIK TË MALISHEVËS F. 11

SPORT

MINISTRJA DUMOSHI: PAKOJA EMERGJENTE DO TË DEDIKOHET EDHE PËR SPORT F. 6

KOSOVA KËRKON NGA BE-ja LIBERALIZMIN E VIZAVE



Kryeministri i vendit, Avdullah Hoti, të mërkurën ka kërkuar nga ambasadorët e BE-së liberalizimin e vizave, duke përmendur ndikimet që do të kishte ky proces te qytetarët e Kosovës. Na anën tjetër, Greqia ia ka

konfirmuar Kosovës mbështetjen për liberalizim të vizave. Ndërsa Instituti EPIK përmes një studimi ka paraqitur katër faktorët që po e pengojnë liberalizimin e vizave për Kosovën | FAQE 3

MINISTRI LIKAJ KËRKON QË TË SHTYHET REFORMA NË ARSIM NË KOMUNËN E KAMENICËS | FAQE 5



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjiibiznesi.com
info@kolegjiibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Takimi i radhës Hoti - Vuçiq vihet në pikëpyetje

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Edhe pse ishte paralajmëruar se më 28 shtator, në Bruksel, do të zhvillohej takimi i radhës i nivelit të lartë midis Prishtinës dhe Beogradit, ku do të takoheshin kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, mbajtja e këtij takimi është vënë në pikëpyetje.

Burimet diplomatike në Bruksel thanë për "Radion Evropa e Lirë" se ende nuk është e sigurt nëse do të mbahet ky takim sepse ende nuk kanë konfirmim nga palët. Arsye për moszhvillimin eventuale të takimit mund të jetë refuzimi i Kosovës për të biseduar për formimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe, çështje për të cilën u tha se do të diskutohet në kuadër të temës së "aranzhimeve për komunitetet joshumicë".

Në BE kanë pohuar se për të diskutuar për këtë temë, sikur edhe për çështjet e lidhura me pretendimet financiare dhe pronësore, kryeministri Hoti dhe presidenti Vuçiq ishin pajtuar gjatë takimit të tyre të mbajtur para dy javësh. Për temat pronësore dhe

financiare delegacionet e të dyjave vendeve në nivel të ekspertëve biseduan javën e kaluar dhe BE-ja paralajmëroi se në ditët në vijim do të diskutohet për çështjen e "aranzhimeve për komunitetet joshumicë".

Delegacioni i Serbisë, siç kishin konfirmuar edhe palët në dialog, kishte insistuar që për themelimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe të diskutohet edhe në takimin e fundit të ekspertëve, por pala e Kosovës kishte refuzuar një gjë të tillë. Pas atij takimi, shefi i delegacionit i Serbisë në dialog, në kuadër të nivelit të ekspertëve, Marko Gjuriq, kishte thënë se Serbia do ta shqyrtojë pjesëmarrjen në takimet e radhës dhe do ta kushtëzojë atë me gatishmërinë e Prishtinës për ta themeluar asociacionin e komunave me shumicë serbe. Gjuriqi ishte shprehur se Serbia pret që BE-ja dhe vendet anëtare të bëjnë presion mbi Prishtinën zyrtare lidhur me këtë çështje.

Në BE ende nuk kanë një përgjigje të prerë se a do të zhvillohet apo jo takimi i paraparë për 28 shtator. Por, disa burime diplomatike



pohojnë se, nëse delegacioni i Kosovës vazhdon të kundërshtojë që të diskutohet për "aranzhimet për komunitetet joshumicë", atëherë do të jetë e vështirë që të organizohet takimi ndërmjet Hotit dhe Vuçiqit. "Nuk mund të bisedohet vetëm për temat të cilat i dëshiron njëra palë e të mos diskutohet edhe për temat që paraqet pala tjetër", ka thënë një burim diplomatik në Bruksel.

Në Kosovë në javën e kaluar u krijua debat mes liderëve politikë nëse duhet që për

temën e asociacionit të diskutohet në dialogun e ndërmjetësuar nga Brukseli. Në anën tjetër, në BE pohojnë se Kosova, pasi ka nënshkruar marrëveshje për themelimin e asociacionit, tani duhet të dalë edhe me propozim se si ta zbatojë atë.

Por, i pyetur se a do të pranojnë që kjo të realizohet sipas vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, të vitit 2015, ku Gjykata gjeti se Marrëveshja për themelimin e Asociacionit në 23 pika të saj ishte në kundërshtim me

Kushtetutën e Kosovës, shefi i delegacionit i Serbisë, Marko Gjuriq, kishte deklaruar se "e ashtuquajtura Gjykatë Kushtetuese nuk duhet të ketë rol në këtë" dhe këtë përfshirje të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës e kishte vlerësuar si tentim për ta penguar zbatimin e kësaj pjese të marrëveshjes.

Në BE thonë se vazhdojnë të punojnë në përpjekjet për ta organizuar edhe takimin në fjalë në nivel të lartë në mes të Kosovës dhe Serbisë javën që vjen.

Konstituohet Kuvendi i Malit të Zi pa praninë e Gjulkanoviçit

Podgoricë, 23 shtator - Të mërkurën në Mal të Zi është konstituuar përbërja e re e Kuvendit në të cilin shumicën do ta kenë tre koalicionet: "Për ardhmërinë e Malit të Zi", "Paqja është kombi ynë" dhe "E zeza mbi të bardhë", të drejtuara nga Zdravko Krivokapiq, Aleksa Beçiq dhe Dritan Abazović.

Seanca konstituive filloi me intonimin e himnit kombëtar dhe në këtë ceremoni nuk morën pjesë disa anëtarë të Frontit Demokratik. Megjithatë, udhëheqësi i listës "Për Ardhmërinë e Malit të Zi", Zdravko Krivokapiq, me deputetët dhe mysafirë të tjerë të pranishëm respektuan himnin kombëtar.

Në seancë nuk mori pjesë presidenti i Malit të Zi, Milo Gjukanović.

Pas verifikimit të mandateve të deputetëve të përbërjes së re të Kuvendit, kryesuesi Miodrag Lekiq tha, ndër të tjera, se për herë të parë ka pasur një ndryshim të qeverisë dhe

transferim paqësor të pushtetit. Ai tha se nuk do të ketë asnjë revanshizëm në lidhje me qeverinë e mëparshme dhe këmbënguli në dinjitetin dhe pavarësinë e kuvendit si institucion.

Shumica parlamentare përbëhet nga tri koalicionet: "Për Ardhmërinë e Malit të Zi" i udhëhequr nga Zdravko Krivokapiq që fitoi 27 vende, koalicioni "Paqja është kombi ynë" i udhëhequr nga Aleksa Beçiq, me dhjetë vende dhe koalicioni "E zeza mbi të bardhë" i udhëhequr Lëvizja qytetare, Dritan Abazović me katër vende.

Partia Demokratike e Socialistëve, e presidentit Milo Gjukanović, ka fituar 30 vende në përbërjen e re të parlamentit. Partia Boshnjake dhe Social-Demokratët fituan nga tri vende secila, Partia Socialdemokrate dy, dhe nga një vend në parlament e kanë fituar: Lista Shqiptare "Nik Gjelošhaj-Genci Nimanbegu" dhe koalicioni "Bashkë një za".



Seancës konstituive të Kuvendit i parapriu një përpjekje për të arritur një marrëveshje midis përfaqësuesve të tri koalicioneve dhe drejtuesve të subjekteve politike të shumicës së re parlamentare, mbi mandatarin dhe përbërjen e qeverisë dhe ndarjen e ministrive.

Negociatat që u zhvilluan më 22

shtator, në manastirin e Ostrogut me ndërmjetësimin e Peshkopit të Kishës Ortodokse Serbe, Amfilohije, sipas pretendimeve të disa pjesëmarrësve, përfunduan pa rezultat.

Më parë krerët e tri koalicioneve fituese të zgjedhjeve kanë bërë publike parimet për formimin e qeverisë së ardhshme të Malit të

Zi. Liderët e tri subjekteve politike të koalicionit opozitar kanë thënë se qeverisja e tyre do ta përfshijë edhe bashkëpunimin me aleancën e NATO-s, mosvënien në diskutim të njohjes së Kosovës dhe se do ta përjashtojnë mundësinë e ndryshimit të simboleve shtetërore të Malit të Zi.

Kosova kërkon nga BE-ja liberalizimin e vizave

Kryeministri i vendit, Avdullah Hoti, të mërkurën ka kërkuar nga ambasadorët e BE-së liberalizimin e vizave, duke përmendur ndikimet që do të kishte ky proces te qytetarët e Kosovës. Në anën tjetër, Greqia ia ka konfirmuar Kosovës mbështetjen për liberalizim të vizave. Ndërsa Instituti EPIK përmes një studimi ka paraqitur katër faktorët që po e pengojnë liberalizimin e vizave për Kosovën



EPIK-U PUBLIKON FAKTORËT QË PO PENGOJNË LIBERALIZIMIN E VIZAVE PËR KOSOVËN

Instituti EPIK ka publikuar të mërkurën studimin "KOSOVA-BE 2.0: Hapat e ardhshëm në procesin integruar të Kosovës", ku ka paraqitur katër faktorë që po e pengojnë liberalizimin e vizave për Kosovën. "Mungesa e rezultateve në kuadër të luftës kundër korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimin të organizuar. Katër vjet pas kërkesës së Komisionit Evropian për përmbushjen e kriterit të luftës kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë, ne ende s'kemi asnjë aktgjykim dënues të profilin të lartë për korrupsion", është thënë në këtë studim, duke shtuar se ende nuk kanë arritur ta kthejnë besimin në

institucionet e sundimit të ligjit. "Raporti i vendit 2019 identifikoj sfida të shumta në fushën e sundimit të ligjit. Në veçanti, vendet anëtare me shqetësim janë duke përcjell të gjeturat e Raportit të Vendi, ku është konkluduar se korrupsioni është i përhapur në të gjitha nivelet institucionale dhe institucionet e drejtësisë janë duke ndërmarrë veprimet nën ndikimin politik. Kosova u konfirmua se është vendi i fundit në Ballkan në kuadër kapitujve të ndërlidhur me sundimin e ligjit - kapitulli 23 dhe 24", ka vlerësuar EPIK-u. Kurse dy faktorët e tjerë janë ngecja e dialogut me Serbinë dhe mungesa e vullnetit politik të institucioneve të Kosovës për këtë proces. "Ngecjet në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi. Mungesa e progresit në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë është një pengesë indirekte pasi që vendet anëtare të BE-së e

shohin bashkëpunimin rajonal si parakusht themelor në kuadër të të gjitha proceseve integruarë, përfshirë edhe liberalizimin e vizave. Mungesa e vullnetit politik për liberalizim të vizave. Kosova ka pasur momentumin pozitiv për liberalizimin e vizave në vitin 2016, sidoqoftë sot çështja e hapjes së kufijve është çështje me implikime të shumta politike brenda disa vendeve anëtare të BE-së", është vlerësuar në këtë studim. Po në këtë studim instituti EPIK ka vlerësuar se me qëllim të adresimit të këtyre sfidave, institucionet duhet të bëjnë përparim në arritjen e rezultateve në kuadër të luftës kundër korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimin të organizuar, të tregojnë vullnet të qartë politik për reformat e sundimit të ligjit, të bëjnë përparim në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë dhe ta shtojnë komunikimin me vendet anëtare të BE-së.

EPOKA
ERE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka zhvilluar të mërkurën një bisedë virtuale me ambasadorët e BE-së, të cilëve ua ka kërkuar liberalizimin e vizave. Me këtë rast ai ka thënë se ky veprim do të hapte një mundësi reale për qytetarët dhe bizneset e Kosovës dhe do të krijonte mundësi të reja të zhvillimit ekonomik të vendit. "Ambasadorët i kam njoftuar edhe për procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke vlerësuar se qeveria pret që ky proces të përmbillet me marrëveshjen gjithëpërfshirëse dhe ligjrisht obliguese, që përfundon me njohjen reciproke ndërmjet dy vendeve. Në anën tjetër, liberalizimi i vizave mbetet ndër çështjet kyçe që duhen zgjidhur me BE-në, veprim ky që do të hapte një mundësi reale për qytetarët dhe bizneset e Kosovës dhe do të krijonte mundësi të reja të zhvillimit ekonomik të vendit", ka shkruar Hoti në profilin e vet në "Facebook". Ndërsa ministrja për Punë të Jashtme dhe Diasporë, Meliza Haradinaj-Stublla, ka marrë

mbështetjen e Greqisë për këtë proces. Kjo ka ndodhur në një videokonferencë me ministrin e Jashtëm të Greqisë, Nikos Dendias, në kuadër të sesionit të 75-të të UNGA-s. "Homologu grek ma konfirmoi mbështetjen e madhe të Greqisë për përmblylljen e liberalizimit të vizave për Kosovën, duke theksuar nevojën e bashkëpunimit të gjerë rajonal politik dhe ekonomik, për ta ruajtur qëndrueshmërinë e paqes dhe stabilitetit dhe fuqizuar perspektivën eurointegruarë të rajonit", ka shkruar ministrja Haradinaj-Stublla në llogarinë e vet në "Facebook".

Ajo ka treguar se me homologun grek ka theksuar nevojën e thellimit të marrëdhënieve tona dypalëshe. "Me ministrin Dendias biseduam edhe për Marrëveshjen e Uashingtonit që i hapë rrugë marrëveshjes finale të njohjes reciproke në kufijtë ekzistues dhe që respekton rendin kushtetues e karakterin unitar të Republikës së Kosovës. Me homologun grek theksuam nevojën e thellimit të marrëdhënieve tona dypalëshe, duke thelluar edhe më tej dialogun praktik që kemi me Greqinë", ka shkruar ajo.

Hoti: Të shfrytëzohet momentumimi pas nënshkrimit të marrëveshjes në Uashington

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë të mërkurën se Kosova dhe institucionet e saj duhet ta shfrytëzojnë momentumin e ri të krijuar, sidomos pas nënshkrimit të marrëveshjes ekonomike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në Uashington. Ai ka bërë këto komente pas takimit që ka zhvilluar me drejtuesit e Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi dhe atë të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka. Përgjatë takimit, Hoti ka thënë të jetë diskutuar për



rimëkëmbjen ekonomike. "Mbi të gjitha, është e rëndësishme si qeveri dhe komunitete të bizneseve, si Oda Ekonomike,

të qëndrojnë bashkë, pa përjashtim për ta shfrytëzuar momentumin e jashtëzakonshëm që është krijuar me nënshkrimin e marrëveshjes së Uashingtonit. Janë së paku 1 miliard dollarë financim për projekte infrastrukturore", ka deklaruar Hoti. Të martën në Beograd, në rezidencën e ambasadorit amerikan në Serbi, odat ekonomike të Kosovës dhe Serbisë njoftuan se janë pajtuar që të krijojnë një grup punues, që do t'i ndihmojë qeveritë e të dyja shteteve për t'i zbatuar

projektet e marrëveshjes së Uashingtonit nga 4 shtatori si dhe të ofrojë mbështetje për zbatimin e projekteve të infrastrukturës, të energjisë dhe krijimit të vendeve të punës. Në takim kanë marrë pjesë drejtori i Korporatës, Adam Boelher, i dërguari i posaçëm i presidentit amerikan për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, ambasadori Godfrey, përfaqësuesit e odave të Kosovës dhe Serbisë, Berat Rukiqi, respektivisht Marko Çadezh si dhe kryetari i Odës Amerikane në Serbi, Zoran Petroviq.



FLET PËR "EPOKËN E RE", HYSNI GUCATI

SPECIALJA MË S'KA KREDIBILITET PËR DREJTËSI

Kryetari i Organizatës së Veteranëve i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Hysni Gucati, ka thënë se kredibiliteti i Gjykatës Speciale ka rënë përtokë. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka theksuar se pas rrjedhjes së mijëra dosjeve ky institucion nuk mund të vendosë më drejtësi. Gucati ka deklaruar se tani kjo gjykatë do të duhej të mbyllej. Sipas tij, OVLUÇK-ja nuk është fajtorë pse Gjykatës Speciale i kanë dalë nga dora dokumentet. Gucati ka përsëritur se OVLUÇK-ja nuk është kundër drejtësisë

gjejë prova, por nuk ia ka arritur. Pra, do të duhej që kësaj gjykate t'i vihej një dry i madh dhe të mbyllej", është shprehur Gucati.

I pari i veteranëve u është përgjigjur kritikave të Speciales për OVLUÇK-në, duke thënë se kjo organizatë nuk është fajtorë për rrjedhjen e dosjeve nga kjo gjykatë. "Organizata e Veteranëve e Luftës së UÇK-së nuk është duke tentuar ta minojë punën e Gjykatës Speciale. Kjo gjykatë e ka minuar vetveten. Së dyti, të gjithë e dinë që OVLUÇK-ja është kundër kësaj gjykate dhe këtë e kemi thënë me kohë. Pra, ne nuk po themi këtë sot e as dje, por e kemi thënë që pesë vjet vazhdimisht, prej se është formuar Gjykata Speciale", ka

thënë Gucati.

Ai ka përsëritur se kjo organizatë nuk është kundër drejtësisë. Sipas Gucatit, OVLUÇK-ja është kundër drejtësisë selektive që është duke e bërë Gjykata Speciale. "Ne nuk jemi fajtorë pse atyre u dalin në publik materialet. Çdokush duhet ta ruajë shtëpinë e vet dhe mallin që ka. Ne nuk jemi kundër drejtësisë. Nuk kemi qenë dhe as nuk do të jemi. Ne jemi për një drejtësi të mirëfilltë dhe jo për drejtësi selektive siç është duke e bërë Gjykata Speciale", ka thënë Gucati.

"Epoka e re": Z. Gucati, Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë ka deklaruar se me publikimin e disa dosjeve Organizata e Veteranëve e

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Hysni Gucati, ka deklaruar se me nxjerrjen e mijëra dosjeve në publik Gjykatës Speciale i ka humbur kredibiliteti. Ai ka thënë se kjo gjykatë më nuk mund të vendosë drejtësi.

Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka treguar se synimi i OVLUÇK-së është ta dëmtojë Gjykatën Speciale dhe jo Kosovën. "Mendoj se Gjykatës Speciale i ka humbur kredibiliteti. Kjo gjykatë s'ka më imazh për të bërë drejtësi. Kjo mund ta vazhdojë punën, por nuk ka aspak kredibilitet. Kësaj gjykate i kanë dalë gjërat nga dora. Ky institucion më nuk

mund të vendosë drejtësi. Por, këta janë evropianë, nuk e kanë fort gajle këtë gjë. Këta mund të ngrehin aktakuza, mund ta vazhdojnë punën, por kjo gjykatë më s'ka kredibilitet", ka thënë Gucati. Ai ka deklaruar se pas këtij skandali kjo gjykatë do të duhej të mbyllej. "Më pas pak nder kjo gjykatë do të duhej të thoshte se deri këtu e ka pasur misionin. Është munduar të

Luftës së UÇK-së është përfshirë në aktivitete që kanë për qëllim minimin e administrimit të drejtësisë. Cili është koment juaj?

Gucati: Organizata e Veteranëve e Luftës së UÇK-së nuk është duke tentuar ta minojë punën e Gjykatës Speciale, sepse ajo është duke minuar vetveten. Së dyti, të gjithë e dinë se OVLUÇK-ja është kundër kësaj gjykate dhe këtë e kemi thënë me kohë. Pra, ne nuk po themi këtë sot e as dje, por e kemi thënë që pesë vjet vazhdimisht, prej se është formuar Gjykata Speciale. Ne nuk jemi fajtorë pse atyre u dalin në publik materialet. Çdokush duhet ta ruajë shtëpinë e vet dhe mallin që ka. Ne nuk jemi kundër drejtësisë. Nuk kemi qenë dhe as nuk do të jemi. Ne jemi për një drejtësi të mirëfilltë dhe jo për drejtësi selektive siç është duke bërë Gjykata Speciale. Kështu që, neve nuk na intereson se çfarë ka thënë Gjykata Speciale për ne. Ajo mund të thotë gjithçka. Mund të na hetojë dhe të na përcjellë. Ne kemi treguar se zyrën e kemi në Prishtinë. Jetojmë këtu dhe do t'i përgjigjemi nëse ajo na thërret.

"Epoka e re": A keni pasur deri më tani ndonjë reagim tjetër prej Speciales apo prej ndonjë organi tjetër të drejtësisë vendore për këto aktivitete?

Gucati: Deri më tani nuk kemi pasur ndonjë reagim, pra as prej Speciales, as prej

Prokurorisë së Kosovës. Ajo që dihet, është se më herët zyrtarët e Speciales kanë qenë në zyrat tona dhe na kanë thënë se nuk është mirë të bëhet kjo. Ne u kemi thënë se nuk mund ta ruajmë materialin e saj. Gjithashtu, u kemi thënë se jemi kundër kësaj gjykate. OVLUÇK-ja, po të kishte mundësi, për pesë minuta do ta zhbente Gjykatën Speciale.

"Epoka e re": A prisni dosje të tjera?

Gucati: Nëse i sjellin natyrisht se do t'i publikojmë.

"Epoka e re": Keni thënë se personi që po sjell dosje ka paralajmëruar edhe sjelljen e CD-ve. Do t'i publikoni edhe ato?

Gucati: Të gjitha. Çfarëdo që vjen në zyrat tona do të publikojmë.

"Epoka e re": Jeni në dijeni se kush po i sjell këto dosje tek OVLUÇK-ja?

Gucati: Jo. E kemi ftuar edhe Prokurorinë Speciale të Kosovës që ta hetojë rastin dhe ta gjejë se kush është duke bërë një gjë të tillë. Ne jemi të gatshëm të bashkëpunojmë me drejtësinë dhe t'ua japim kamerat tona. Por, ne nuk e dimë se kush po i sjell dosjet në zyrat tona. Këtë le ta zbulojnë organet e drejtësisë që e kanë për obligim.

"Epoka e re": A po i sjell i njëjti person këto dosje?

Gucati: Me sinqeritetin më të

madh po ju them se nuk e dimë se a është njëjti person apo janë personat të ndryshëm.

"Epoka e re": Është thënë se këto veprime të OVLUÇK-së janë kundër Kosovës, sepse e dëmtojnë drejtësinë në këtë proces. Jeni të vetëdijshëm për këtë?

Gucati: Ne kemi dhënë shumë për këtë vend dhe nuk duam ta dëmtojmë shtetin tonë. Interesi ynë nuk është që ta dëmtojmë Kosovën, por që ta dëmtojmë Gjykatën Speciale, sepse kjo gjykatë nuk është e drejtë dhe nuk duhet të ekzistojë.

"Epoka e re": Këto dokumente janë vetëm të Speciales apo edhe dokumente të organeve serbe të drejtësisë?

Gucati: Këto janë dokumente kopje të Gjykatës Speciale. Zyrtarët e kësaj gjykate vetë e kanë konfirmuar se janë dokumente të tyre. Ata kanë ardhur dhe i kanë marrë ato në zyrat e OVLUÇK-së. Ka edhe dokumente të Prokurorisë së Serbisë që tregojnë se ka bashkëpunuar me Gjykatën Speciale.

"Epoka e re": Si OVLUÇK, keni ndonjë dyshim se kush mund ta bëjë këtë, se kush është i interesuar t'i nxjerrë këto dosje?

Gucati: Nuk e dimë. Nuk kemi ndonjë dyshim se kush mund ta bëjë këtë. Neve na kanë ardhur në zyrë dhe ne i kemi publikuar.

"Epoka e re": Frikësoheni se mund të jeni objekt i ndonjë ndjekje penale për këto veprime?

Gucati: Ne deri më tani nuk besoj se kemi bërë ndonjë shkelje ligjore, sepse nuk kemi publikuar emra apo diçka të tillë. Mendoj se nuk ka bazë për ngritje të ndonjë aktakuze. Ajo edhe mund të ngrehet, por frikën ne nuk ia kemi.

"Epoka e re": Mendoni se me nxjerrjen në publik të këtyre dosjeve është dëmtuar kredibiliteti i kësaj gjykate për ta vazhduar punën?

Gucati: Mendoj se Gjykatës Speciale i ka humbur kredibiliteti. Kjo gjykatë s'ka më imazh për të bërë drejtësi. Kjo mund ta vazhdojë punën, por nuk ka aspak kredibilitet. Kësaj gjykate i kanë dalë gjërat nga dora. Ky institucion më nuk mund të vendosë drejtësi. Por, këta janë evropianë, nuk e kanë fort gajle këtë gjë. Këta mund të ngrehin aktakuza, mund ta vazhdojnë punën, por kjo gjykatë më s'ka kredibilitet. Kredibiliteti i saj është rrafsh me tokë, sepse i kanë dalë dokumentet nga dora.

"Epoka e re": Meqenëse mendoni se kjo gjykatë s'ka më kredibilitet për punë, atëherë çfarë duhet të ndodhë me të?

Gucati: Me pas pak nder, kjo gjykatë do të duhej të thoshte se deri këtu e ka pasur misionin. Është munduar të gjejë prova, por nuk ia ka arritur. Pra, do të duhej që kësaj gjykate t'i vihej një dry i madh dhe të mbyllej.

Ministri Likaj kërkon që të shtyhet reforma në arsim në Komunën e Kamenicës

**EPOKA
ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e radhës, nën drejtimin e nënkryetarit Jahja Koka, në të cilën, për të folur lidhur me reformën në arsim në Komunën e Kamenicës, të ftuar ishin ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj dhe kryetari i Kamenicës, Qëndron Kastrati.

Para anëtarëve të komisionit, ministri Ramë Likaj ka kërkuar nga kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, që të shtyhet reforma në arsim për një vit në mënyrë që nxënësit t'i ndjekin mësimet dhe të mos mbesin jashtë procesit mësimor. "Kërkesa ime e vazhdueshme ka qenë që të gjendet një zgjidhje e pranueshme për më se 400 nxënës të cilët nuk vijojnë mësimin edhe pse viti shkollor

ka filluar në të gjitha komunat e Kosovës. Kam kërkuar me mirëkuptim që të shtyhet kjo lloj reforme, meqenëse jemi në kohë pandemie. Çështje tjetër shqetësuese është edhe aspekti ekonomik si dhe kushtet e vështira atmosferike, në të cilat nxënësit duhet të udhëtojnë", ka thënë ministri Likaj.

Ai, po ashtu, u ka bërë thirrje prindërve dhe kryetarit Kastrati që të shtyhet reforma edhe në vitin 2021. Ndërkaq i pari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka thënë se kjo iniciativë qëllim ka të mirën e nxënësve dhe arsimimit në mirëfilltë. Ai ka shtuar se komuna që drejton ai është duke e përmirësuar gjendjen në arsim. "Kamenica dallon dukshëm nga komunat e tjera. Shkalla e migrimit është e lartë, 25 klasë me nga 1 nxënës, 19 klasë me nga 2 nxënës, 7 shkolla në më pak se 20 nxënës. Unë e kam për obligim të siguroj arsim cilësor. Ne jemi komuna e vetme që



angazhojmë në shkolla psikologë, pedagogë, logopedë e asistentë për nxënësit me nevoja të veçanta dhe e gjithë ky është rezultat i reformës në arsim", ka theksuar kryetari Kastrati. Ai ka vënë në dukje se Komuna e Kamenicës po i zbaton ligjet dhe

detyrat për të organizuar arsim cilësor.

Anëtarët e komisionit shtruan pyetje në adresë të kryetarit Kastrati, duke treguar vullnet dhe përkushtim për gjetjen e një zgjidhjeje sa më të mirë dhe të shpejtë, në mënyrë që nxënësit

të futen në procesin mësimor. Ndërkaq, nga shumica e anëtarëve të komisionit si sfida u konsiderua çështja e migrimit të nxënësve në qytete. Gjatë diskutimit u kërka që të gjendet një zgjidhje përtej partive dhe interesave politike.

IKD-ja: Prokuroria e Apelit punën e bazon në shabllone, pa ndonjë ndikim real në vendimet e Gjykatës së Apelit

EPOKA E FATON DËRMAKU

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), me përkrahje të Departamentit të Shtetit Amerikan - Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtarë dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe NED-it, të mërkurën ka mbajtur konferencë për media, në të cilën ka publikuar raportin "Prokuroria Pasive e Apelit", i cili raport është rezultat i monitorimit dhe hulumtimit sistematik që IKD i ka bërë kësaj prokurorie gjatë tre vjetëve të fundit.

Drejtor ekzekutiv i IKD-së, Ehat Miftaraj, tha se Prokuroria e Apelit, shikuar për nga numrat, del se është ndër institucionet më efikase në Kosovë, me performancë thuajse 100 për qind në trajtimin e lëndëve që pranojnë. Mirëpo, Miftaraj shtoi se përderisa me kuantitet kjo prokurori qëndron mirë, e kundërta është lidhur me kualitetin apo autoritetin që kjo prokurori ka në Gjykatën e Apelit, e që del se është barazi me zero. Sipas Miftarajt, në bazë të monitorimit të IKD-së, del se prokurorët e kësaj prokurorie zyren dhe funksionin e tyre e kanë kthyer në një zyrë postare e cila proceson shkresa dhe punën e tyre e bazon në praktika të shabllonëve. Përderisa, ankesat ndaj vendimeve hartohen nga prokurorët e shkallës së parë, prokurorët e apelit, punën e tyre

e bazojnë kryesisht në hartimin e një propozimi shabllon, ku kërkohet nga Gjykata e Apelit ta aprovojë si të bazuar apo refuzojë ankesën e prokurorit, pa ndonjë elaborim apo argumentin të mirëfilltë dhe pjesëmarrje aktive në përmirësimin e kualitetit të ankesave që parashtrihen në Gjykatën e Apelit.

Ndërsa Lavdim Bajraktari, hulumtues në IKD, tha se ajo çka e dallon në këtë rast Prokurorinë e Apelit nga prokuroritë themelore dhe PSRK, është se puna e kësaj prokurorie është e fokusuar kryesisht në analizimin e ankesave të cilat i hartojnë prokuroritë e shkallës së parë, palët e dëmtuara si dhe të akuzuarit me mbrojtësit e tyre dhe pas analizimit të këtyre ankesave dhe aktgjyqimeve të shkallës së parë, kjo prokurori i drejtohet me një parashtrësë Gjykatës së Apelit së cilës mund t'i propozojë aprovimin, hedhjen poshtë të ankesave apo ndryshimin e aktgjykimit.

Mirëpo ndikimi real i këtyre propozimeve të Prokurorisë së Apelit, në aktgjyqimet që i merr gjykata e shkallës, sipas Bajraktarit, është thuajse plotësisht irelevant. "Në vetëm një nga 100 aktgjyqimet e Gjykatës së Apelit që janë analizuar për këtë hulumtim, del se propozimi i Prokurorisë së Apelit është përmendur dhe marrë parasysh në arsyetim të aktgjykimit. Në të gjitha arsyetimet e aktgjyqimeve të



tjera, propozimet e Prokurorisë së Apelit janë inekzistente", tha Bajraktari. Sipas Bajraktarit, nga kjo del se vendimet e saj Gjykata e Apelit thuajse të gjitha rastet i bazon në ankesat që bëhen nga prokuroria themelore, palët e dëmtuara dhe ato të akuzuara, kurse ndikimi i propozimeve të Prokurorisë së Apelit del se është thuajse krejt i parëndësishëm. Po ashtu, Bajraktari tha se shqetësuese në rastin e Prokurorisë së Apelit është edhe fakti se prokurorët e kësaj prokurorie, në shumicën dërrmuese të rasteve nuk prezantojnë në seancat e Gjykatës së Apelit. Sipas tij, përkundër se mospjesëmarrja e prokurorëve të Prokurorisë së Apelit në seancat publike që mban Gjykata e Apelit nuk është

pengesë procedurale për mbajtjen e seancave, përfaqësimi në këto seanca mbetet një ndër mundësitë e vetme që kanë prokurorët e Apelit, që të tregojnë edhe atë kreativitetin e tyre në argumentimin sa më të mirë para gjyqtarëve se pretendimet ankimore të dhëna nga prokurorët e shkallës së parë janë të bazuara. "Nga 438 seancat që ka monitoruar IKD gjatë viteve 2018 dhe 2019, Prokuroria e Apelit kishte prezantuar në vetëm 4 për qind të tyre", tha Bajraktari. Më tutje, Bajraktari shtoi se niveli i ankesave të ushtruara nga Prokurori i Shtetit e të cilat aprovohen nga ana e Gjykatës së Apelit vazhdon të jetë shumë i ulët duke përmendur

statistikat e Raporteve të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional, sipas të cilave, niveli i ankesave të prokurorëve që aprovohen nga Gjykata e Apelit është më i ulët se 10 për qind.

Në fund, Bajraktari numëroi disa nga rekomandimet që IKD ka dhënë në këtë raport, ndër të cilat përfshihen ajo që Prokuroria e Apelit duhet të ndërtojë një qasje më proaktive në mbrojtjen e ankesave të Prokurorit të Shtetit në Gjykatën e Apelit, pjesëmarrja e prokurorëve të Apelit në seancat e shkallës së dytë, që për dështimin e organit të ndjekjes në rastet në shkallë të dytë, KPK të mbajë përgjegjës edhe Prokurorinë e Apelit dhe të tjera.

PDK-ja në Prizren: LV-ja nuk ka kapacitete menaxhuese

PRIZREN, 23 SHTATOR - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në Prizren përmes një komunikate për media ka thënë se Lëvizja Vetëvendosje nuk ka aftësi menaxhuese dhe se Komuna e Prizrenit nuk ka arritur as minimumin e pikëve për të konkurruar për Grantin e Performancës Komunale, ku u ndanë 4.9 milionë euro shpërbllim për komunat me performancën më të mirë. Sipas njoftimit të PDK-së në Prizren, në vlerësimin e performancës nga ministria, Prizreni është vendosur në vendin e 23-të. "Sikur që po vërehet, Komuna e Prizrenit nuk e ka arritur as minimumin e pikëve, për të konkurruar e lëre më për të fituar. Po ashtu, një vlerësim tjetër i performancës së komunave nga ministria respektive, bazuar në kriteret relevante të matjes së

performancës, e ka vendosur Komunën e Prizrenit në vendin e 23-të, që është nën mesataren, si dhe në vendin e 24-t Prishtinën. Sipas një klasifikimi tjetër, Komuna e Prizrenit është radhitur në vendin e 10 në nivel vendi sa i përket performancës për shërbimet administrative", thuhet në njoftimin e PDK-së në Prizren.

PDK-ja në Prizren njofton se para Komunës së Prizrenit kanë dalë disa komuna më të vogla si: Rahoveci që është radhitur i pari, pastaj Suhareka, Viti, Istogu, Lipjani etj. "Specifikisht po i përmendim këto dy komuna: Prizrenin dhe Prishtinën, sepse Prishtina ka qenë e udhëhequr nga LV-ja dhe po dëshmohej se, përveç mungesës së kapaciteteve menaxhuese dhe resurseve humane, problem mund të kenë edhe ideologjinë dhe mungesën e një koncepti të



avancuar qeverisës", thuhet në komunikatën e PDK-së në Prizren. Qyteti i Prizrenit, sipas PDK-së

atje, në vazhdimësi po ballafaqohet me pasoja të kësaj filozofie dhe mënyrë të qeverisjes ku, sipas tyre, asgjë

nuk respektohet, përfshirë këtu edhe partnerët e koalicionit që e sollën në pushtet kryetarin aktual.

Në 24 orët e fundit, një pacient i vdekur, 62 të infektuar me Covid në Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë ka raportuar të mërkurën për 62 raste të reja me Covid-19, pas marrjes së 528 mostrave. Sipas këtij Instituti, përgjatë 24 orëve të fundit është regjistruar një viktimë, duke e çuar në 616 numrin total të të vdekurve me Covid-19 në Kosovë.

Autoritetet shëndetësore kanë raportuar më 23 shtator për 85 persona që kanë mposhtur virusin, derisa raste aktive janë edhe 1 754. Prej raportimit të rasteve të para me koronavirus në Kosovë më 13 mars, IKShPK-ja ka raportuar për 15 270 të prekur me sëmundjen Covid-19 që shkakton koronavirusin.

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar po këtë ditë se në institucionet publike shëndetësore në Kosovë aktualisht janë të shtrirë 202 pacientë, prej tyre 124 janë të prekur me Covid-19.

Në raportin ditor të ShSKUK-së është thënë se katër pacientë janë në respiratorë, gjashtë të tjerë janë duke u trajtuar me makinat e frymëmarrjes CPAP,

kurse 129 të tjerë janë në oksigjenoterapi.

Kosova ka gjithsej 700 shtretër në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe në spitalet rajonale.

Në takimin e Komitetit për Koordinimin dhe Vlerësimin e Situatës Emergjente me Covid-19, ku është bërë vlerësimi i situatës epidemiologjike, është theksuar se situata është stabile. "Sigurojmë qytetarët e vendit, por edhe grupet e interesit, se do të jemi në gjendje gatishmërie, ashtu si deri më tani, për menaxhim sa më të mirë dhe efikas të situatës epidemiologjike. Gjithashtu, do të jemi të kujdesshëm me lëvizje sa i përket liritimit të masave", ka thënë ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj.



AMBULANCA PËR CORONAVIRUS

CDF i dorëzon IKShPK-së 1050 teste molekulare për Covid-19

Fondi për Zhvillimin e Komunitetit (CDF) ka njoftuar se ka bërë dorëzimin e 1 050 testeve molekulare për Covid-19 për GeneXpert në IKShPK. Testet janë siguruar nga fondet e mekanizmit C19RM të Fondit Global, të zbatuara nga Programi i HIV-it në

CDF. Këto teste janë një nga teknologjitë më të reja dhe më të sakta të testimit molekular për Covid -19. Testet janë të shpejta dhe shfrytëzojnë aparaturën GeneXpert të dhuruar për IKShPK nga Granti i Fondit Global për Programin e

Tuberkulozit, të menaxhuar nga CDF. Me futjen në përdorim të kësaj metode do të forcohet dhe diversifikohet sistemi i diagnostikimit të hershëm molekular të Covid -19 dhe kursehen resurset e qytetarëve të Kosovës.

Imri Ahmeti zgjedhet kryetar i Asociacionit të Komunave të Kosovës

Kuvendi i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) me shumicë votash ka zgjedhur kryetarin e Lipjanit, Imri Ahmeti, për kryetar të këtij asociacioni. Mbajtja e këtij kuvendi ishte paraparë të mbahet në muajin mars, por u shty për shkak të pandemisë Covid-19

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) ka mbajtur Kuvendin e Përgjithshëm Vjetor, ku kanë marrë pjesë delegatët nga komunat e Republikës së Kosovës dhe kryetarët e komunave.

Kuvendi me shumicë votash ka zgjedhur kryetarin e Lipjanit, Imri Ahmeti, kryetar të Asociacionit të Komunave të Kosovës. Ushtruesi i detyrës së kryetarit të AKK-së, Xhafer Gashi, ka hapur punimet e kuvendit, ndërsa me shumicë votash janë aprovuar raportet vjetore 2019 dhe planifikimet për 2020.

Mbajtja e këtij kuvendi ishte paraparë të mbahet në muajin mars, por u shty për shkak të pandemisë Covid-19. Kuvendi i përgjithshëm vjetor i AKK-së ka

debatuar edhe për raportet vjetore të punës për vitin 2019 si dhe ka shqyrtuar planin e punës së AKK-së për vitin 2020 si dhe për çështjet e lobimit në interes të komunave të Kosovës gjatë këtij viti.

Gjatë paraqitjes së raportit të punës të AKK-së për vitin 2019, ushtruesi i detyrës së kryetarit të këtij asociacioni, Xhafer Gashi, ka thënë se edhe gjatë vitit 2019, Asociacioni i Komunave të Kosovës ka punuar në funksion të përfaqësimit dhe mbrojtjes së interesave të komunave, ofrimin të shërbimeve të avancuara dhe përmirësimit të performancës së komunave, konsolidimit dhe fuqizimit të strukturave të reja të AKK-së dhe performancës së mirë financiare. "Këto aktivitete janë të bazuara në planin strategjik të AKK-së për vitin 2016-2020, planin vjetor 2019 si



dhe në agjendën legjislativë të qeverisë dhe parlamentit si dhe prioritetet e përcaktuara vjetore nga strukturat udhëheqëse", ka thënë ai. Ai ka shtuar se AKK-ja është kyçur

në agjendë legjislativë të Qeverisë dhe të Kuvendit të Kosovës duke qenë pjesë e grupeve punuese në shqyrtimin e projektligjeve dhe akteve të tjera ligjore në ekzekutiv. "Gjithashtu ka marrë

pjesë në trupat e parlamentit në takime dhe në disa dëgjime publike për t'i mbështetur qëndrimet dhe interesat e komunave të Republikës së Kosovës", ka thënë Gashi.



Për 'Minierën e Re' të KEK-ut, Xhemajli: Qeveria po abuzon qindra miliona euro të shtetit

PRISHTINË, 23 SHTATOR (ER) - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka denoncuar të mërkurën skandalin në lidhje me vendimet e dyshimta për ndërtimin e "Minierës së Re" të Korporatës Energjetike të Kosovës.

Në një konferencë për media, deputeti i PDK-së, Bajrush Xhemajli, ka thënë se fillimisht ish-kryeministri Ramush

Haradinaj, mandej qeveritë në vijim të Kurtit dhe Hotit, kanë vendosur që ta ndërtojnë "Minierën e Re" në drejtimin e gabuar, në fushën e qymyrit në Veri N1, e jo në Fushën Jug e cila ishte pronë e KEK-ut. "Ky është një vendim me dëm të madh ekonomik për buxhetin dhe qytetarët sepse rezultatet e studimeve të tri kompanive të

përfshira tregojnë përparësitë e padiskutueshme të fushës së Jugut, ku mbi 90 për qind e tokës në fushën e Jugut është tokë e KEK-ut", ka thënë deputeti Xhemajli, duke shtuar se braktisja e pronës publike dhe orientimi në prona private përbën një rast të pastër të korrupsionit.

"Ky veprim që shkon kundër

vendimit të Bordit të Drejtorëve të KEK-ut, rekomandimeve të institucioneve kërkimore dhe ekspertëve ka për ta shkatërruar KEK-un dhe sektorin energjetik në përgjithësi", ka thënë ai.

Xhemajli i ka bërë thirrje qeverisë që ta marrë drejtimin e duhur për krijimin e "Minierës së Re" në fushën jug, e mos t'i dëmtojë, në mënyrë të

pariparueshme, resurset nacionale. "Në të kundërtën, nëse vazhdon kjo rrugë e nisur, provohet qartë se Qeveria Hoti synon të vazhdojë një rrugë të abuzimit të parave të shtetit, përmes korrupsionit, i cili do t'i kushtojë qindra milionë euro qytetarëve taksapagues", ka thënë deputeti i PDK-së, Bajrush Xhemajli.

Qeveritarët premtojnë se Kosovën do ta kthejnë në një zonë të gjallëruar ekonomike

PRISHTINË, 23 SHTATOR (ER) - "Tani është krijuar një moment komplet i ri me zhvillimet politike që kanë ndodhur, në veçanti me nënshkrimin e marrëveshjes në Uashington", tha kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, gjatë një vizite që i bëri të mërkurën Odës Ekonomike të Kosovës.

Në takimin e mbajtur në këtë odë, përveç kryetarit të saj, Berat Rukiqi, të pranishëm ishin edhe drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, si dhe disa nga përfaqësuesit e bizneseve të Kosovës.

Kryeministri Hoti theksoi se tashmë është themeluar një fond në Buxhetin e Kosovës prej 365 milionë eurosh, ndërsa një pjesë e konsiderueshme është paguar. Gjithashtu, kryeministri bëri të ditur se Ministria e Financave ka dhënë në dispozicion për këtë fond rreth 100 milionë euro shtesë. "Sot i diskutuam kriteret bazike për shpërndarjen sa më parë, në javët e ardhshme, të këtij fondi, kryesisht për subvencionim të pagave, të eksporteve, për pjesën e bujqësisë dhe gjatë tetorit do ta shohim edhe financimin e masave të tjera të parapara në programin për rimëkëmbjen ekonomike", vijoi kryeministri Hoti, duke shtuar se "për ne është vitale që t'u qëndrojmë afër bizneseve gjatë këtyre

muajve të vështirë".

Kryeministri Hoti, po ashtu, apeloj që Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike, i cili është i dizajnuar për t'i ndihmuar bizneset, të mbështetet nga të gjitha grupet parlamentare në Kuvend. "Ky ligj, bashkë me Fondin për Rimëkëmbje Ekonomike, në total deri në fund të këtij viti iu mundëson bizneseve dhe qytetarëve në Kosovë rreth 700 milionë euro në

dispozicion, prej të cilave për një muaj e përmbyllim pjesën tonë të Fondit për Rimëkëmbje Ekonomike prej 365 milionësh, pastaj pjesa tjetër që vjen prej Ligjit për rimëkëmbje ekonomike", tha kryeministri Hoti.

Po ashtu, kryeministri Hoti tha se është e nevojshme që Qeveria, Oda Ekonomike dhe komuniteti i biznesit të punojnë bashkë, në mënyrë që të shfrytëzohet ky

moment i jashtëzakonshëm që është krijuar me nënshkrimin e marrëveshjes së Uashingtonit, nga e cila janë së paku një miliard dollarë amerikanë financim për projekte infrastrukturore, që janë të listuara në marrëveshje: hekurudha, autostrada, studim i fizibilitetit për hekurudhën për Durrës dhe projekte të tjera infrastrukturore. "Për pesë vjet ne mund ta kthejmë Kosovën në

një zonë të gjallëruar ekonomike, me mijëra vende të reja pune cilësore", tha kryeministri Hoti. Gjithashtu, ai theksoi se i kishte informuar odat ekonomike për programin investues dhe të mbështetjes ekonomike të BE-së për vendet e Ballkanit Perëndimor, ku Kosova zë vend qendror, sepse projektet janë dorëzuar në Komisionin Evropian dhe më 6 tetor pritet të bëhen publike.



Nëse miratohet projektligji, rreth 200 milionë euro do të tërhiqen nga Trusti

EPOKA ERE | **Albulena S. MAVARI**

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Komisioni për Buxhet dhe Transfere ka shqyrtuar raportin vjetor të punës të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2019. Ky raport ka marrë të gjitha votat për. Me këtë rast, Ruzhdi Morina, kryesues i Bordit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, gjatë prezantimit të raportit në komisionin për

Buxhet dhe Transfere, ka thënë se në vitin 2019 për herë të parë 25 për qind të investimeve ishin të orientuara në Kosovë. Sipas tij, me tërheqjen e 10 për qind të kursimeve pensionale pritet që rreth 200 milionë euro të tërhiqen nga fondit. "Fondi në vitin 2019 kishte filluar me një ekspozim të lartë të rrezikut. Gjatë gjithë vitit ishim të kujdesur për shkak se tregjet financiare ishin në presion në marrëdhëniet ndërkombëtare ShBA-Kinë por,

në fakt, përformuam mirë. Kishim rritje të ulët për investimet jashtë vendit për rreth 130 milionë euro. Në vitin 2019 për herë të parë kishim ndryshim. 25 për qind të investimeve ishin të orientuara në Kosovë. Ne kemi vazhduar t'i përmbushim të gjitha detyrat. Numri i shërbimeve është duke u rritur dhe kemi 190 mijë kontribuues online. Gjatë vitit janë shpërndarë gjithsej 53 milionë euro", është shprehur

Morina. Ai ka bërë me dije se nuk kanë qenë të përfshirë në idenë fillestare të tërheqjes së 10-përqindëshit nga Trusti. "Se a duhet a jo, vlera e 10-përqindëshit, në bazë të shifrave, çon rreth 200 milionë euro", është shprehur ai. Drejtori i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, Ardian Zalli, ka thënë se 160 milionë euro janë të paimvestuara dhe kurdo që kalon ligji, ato mund të

shpërndahen te kontributdhënësit që janë të interesuar. Kryesuesi i Komisionit për Buxhet dhe Transfere, Hekuran Murati, i ka bërë thirrje koalicionit qeverisës ta kalojë Projektligjin për rimëkëmbje ekonomike dhe mos ta fajësojë opozitën. Për projektligjin për rimëkëmbje ekonomike ka pasur dy tentime për votim por, në mungesë të kuorumit, ka dështuar të votohet ky projektligj.



Abrashi dhe Haliti, memorandum bashkëpunimi për ndërtimin e rrugës Viti-Kerbliq-Kaçanik



PRISHTINË, 23 SHTATOR (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me kryetarin e Komunës së Vitisë, Sokol Haliti, për financimin e projekteve infrastrukturore në këtë komunë. Ministri Abrashi tha se projektet që do të kryhen në Viti mundësojnë lidhjen e qytetit me fshatra, e që do të

ndikojë edhe në aspektin ekonomik. Ministri tha se ka në prioritet kompletimin e infrastrukturës së komunave me impakt në zhvillimin e turizmit dhe bujqësisë, duke krijuar vende të reja të punës. Një ndër projektet më të rëndësishme që do ta financojë Ministria e Infrastrukturës në

Komunën e Vitisë është rruga Viti-Kerbliq-Kaçanik, e ndarë me faza dhe parashihen 2 milionë e 100 mijë euro deri te përfundimi i saj. Ndërsa kryetari i Komunës së Vitisë, Sokol Haliti, theksoi se qytetarët kanë nevojë për këtë rrugë, e cila do të ndikojë në zhvillimin e fshatrave që shtrihen përgjatë rrugës Viti-Kerbliq-Kaçanik.

Kërkohet më shumë profesionalizëm në menaxhimin e kompanive publike të ujërave

PRISHTINË, 23 SHTATOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, mori pjesë të mërkurën në takim të Këshillit Ndërmëtor për Ujërat, në të cilin ishin të pranishëm edhe ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ministri i Bujqësisë, Pylttarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, si dhe ambasadori i Zvicrës, Thomas Kolly dhe zëvendësambasadori i Gjermanisë, Jan-Axel Voss. Hoti, me këtë rast, falënderoi vendet donatore, veçmas Zvicrën dhe Gjermaninë që e kanë

ndihmuar zhvillimin e sektorit të ujërave në vendin tonë. Në këtë takim kryeministri Hoti kërkoi profesionalizëm më të lartë nga bordet e menaxhimit të kompanive publike të ujërave në vend, duke theksuar se në disa kompani gjendja nuk është aspak e mirë sa iu përket inkasimeve, ashtu edhe investimeve. Në këtë kontekst, ai kërkoi që të bëhet një analizë e hollësishme e investimeve të deritanishme në sektorin e ujërave, të shihet performanca e ndërmarrjeve publike në sektorin e ujërave, të shqyrtohet mundësia e krijimit të një trupi të përbashkët koordinues i kompanive të ujit, si

dhe të rishikohet Rregullorja e Punës e Këshillit Ndërmëtor, pas zgjerimit të tij edhe me ministrin e Shëndetësisë dhe me atë të Bujqësisë. Në kuadër të bashkërendimit të punës me institucionet e vendeve donatore, Hoti ka pohuar se është e domosdoshme që komunat e Kosovës, konkretisht Komuna e Gjakovës dhe ajo e Prizrenit, t'i kryejnë obligimet e tyre financiare ndaj projekteve ekzistuese. Ndërsa ambasadori i Zvicrës, Thomas Kolly dhe zëvendësambasadori i Gjermanisë, Jan-Axel Voss, theksuan përkushtimin e vendeve të tyre për ta ndihmuar



zhvillimin e sektorit të ujërave në Kosovë, porse kërkuan që, krahas avancimit teknologjik, të ketë

edhe shtim të profesionalizmit në menaxhimin e kompanive të ujërave.

Në Gjilan shënohet 20-vjetori i themelimit të Shoqatës së të Verbërve

GJILAN, 23 SHTATOR (ER) - Është shënuar në Gjilan 20-vjetori i themelimit të Shoqatës së të Verbërve, e cila është bërë nën përkujdesjen e kryetarit Lutfi Haziri.

Në këtë ngjarje ka marrë pjesë nënkryetari Arbër Ismajli, drejtori i Shëndetësisë, Selami Xhemali, kryetari i Shoqatës së të Verbërve në Gjilan, Bajram Spahiu, kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame në Gjilan, Naim Aliu, menaxheri i Handikos në Gjilan, Fatmir Shurdhani e përfaqësues të tjerë.

Në fjalën e rastit, kryetari i Shoqatës së të Verbërve në Gjilan, Bajram Spahiu, e ka falënderuar kryetarin Haziri për organizimin e kësaj ngjarje dhe për mbështetjen e vazhdueshme të ofruar për këtë

kategori të shoqërisë. “Dua t’ju falënderojmë për zotërisht për krejt mbështetjen që e kemi pasur në këto 20 vjet, për realizimin e të drejtave tona si në aspektin ligjor, po ashtu edhe aspektin e realizimit të aktiviteteve, të cilat kanë qenë udhërrëfyes për t’i mbërritur qëllimet tona. Ne si komunitet e kemi një ëndërr, që një ditë komuniteti me aftësi të kufizuara të mos jetë më barrë e shoqërisë, por të jetë i aftë, i pavarur dhe i zoti për vete dhe familjet e tyre”, ka thënë Spahiu. Drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Gjilan, Selami Xhemali, në emër të kryetarit Haziri, i ka uruar kësaj shoqate 20-vjetorin e themelimit sikurse që i ka përgëzuar për punën dhe aktivitetet e tyre. “Ju sigurojmë



që ne si institucione do të vazhdojmë t’ju mbështesim në projektet dhe kërkesat tuaja me të gjitha kapacitetet tona komunale, për personat me aftësi të kufizuara e për shoqatat e tyre”, ka thënë Xhemali.

Në këtë ngjarje ka folur edhe kryetari i Forumit të Personave me Aftësi të Kufizuara, Bujar Kadriu, drejtori i Administratës së Përgjithshme të Shoqatës së të Verbërve të Kosovës, Mexhit Foniqi, drejtori i Qendrës Burimore për Mësim dhe

Këshillim në shkollën “Xheladin Deda” në Pejë, Xhavit Kastrati dhe kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame në Gjilan, Naim Aliu. Në fund janë ndarë mirënjohje falënderimi për avancimin e të drejtave të të verbërve të Gjilanit.

Konfiskohen 55 metër kub në Ferizaj

FERIZAJ, 23 SHTATOR (ER) - Vigjilenca e organeve të shtetit në mbrojtje të mjedisit, po dëshmohe dita-ditës, duke ndëshkuar dëmtuesit e pyjeve. Së fundmi, në një aksion të Policisë së Kosovës në Ferizaj, në koordinim me Drejtorinë e Bujqësisë dhe Pyltariisë, u konfiskuan 55 metër kub masë drusore, e cila po qarkullonte nga Komuna e Kaçanikut për shitje në Ferizaj. Kjo masë drusore ishte tërësisht pa dokumentet e nevojshme dhe u konfiskua nga zyrtarët policorë dhe komunalë.

Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pyltariisë, Burim Bajrami, pas punës që bënë zyrtarët e sektorit të Pyltariisë në drejtorinë e tij, tha se ky aksion dhe të ngjashëm po zhvillohen dhe do të zhvillohen edhe në të ardhmen, me qëllim ndëshkimin e keqbërësve si



dhe mbrojtjen e pyjeve në gjithë territorin e Ferizajt. Ai tha se bashkëveprimi me institucionet e sigurisë, Stacionin Policor në Ferizaj, për të cilën shpreh falënderim publik, dha rezultatet e duhura.

Bartjen e sasisë së konfiskuar të masës drusore e bënë punonjësit e KRM “Pastërtia”. Bëhet me dije se kjo sasi e masës drusore e konfiskuar do të trajtohet me procedurën e rregullt për t’ua ndarë familjeve skamnore në Ferizaj.

Ka filluar rregullimi i shkallëve të Stacionit Policor në Malishevë

MALISHEVË, 23 SHTATOR (ER) - Investimet e Komunës së Malishevës, përkatësisht projektet e planifikuara nga Drejtoria e Urbanizimit, që një ndër to është edhe rregullimi i infrastrukturës së shkallëve të objektit të Stacionit Policor në Malishevë, këto punime i vëzhgoi nga afër drejtori i Drejtorisë së Urbanizimit të Komunës së Malishevës, Ahmet Morina, i shoqëruar nga komandanti i Stacionit Policor të Malishevës, Azem Krasniqi. “Nuk

do të jetë projekti i fundit për ju si institucion që jeni në shërbim të qytetarëve të Malishevës, por ne si drejtori dhe komunë do të kemi prioritet përmirësimin e kushteve të punës, që efikasiteti në punë dhe në shërbim të qytetarëve të jetë sa më cilësor”, ka thënë Morina. Në emër të Stacionit Policor të Malishevës, komandanti Azem Krasniqi u tregua i gatshëm për bashkëpunim dhe mirënjohës për këtë investim të Komunës së Malishevës.



Komuna e Podujevës, memorandum bashkëpunimi me kompaninë SPEEEX

PODUJEVË, 23 SHTATOR (ER) - Nënkryetari i Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Fikret Muratin, drejtor i kompanisë SPEEEX. Qëllimi i këtij memorandum është promovimi i sektorit të bujqësisë, inovacionit dhe ndërmarrësisë për të rinjtë e Komunës së Podujevës në kontekstin e sektorit të Business Process Outsourcing.

Nga kjo marrëveshje Komuna e Podujevës me kompaninë për

qytetarët do të ofrojë: trajnime për fermerë, asistencë profesionale, organizim të ngjarjeve dhe panairëve informuese, si dhe do të mundësohet përfshirja e fermerëve të Komunës së Podujevës në biznesmodelin e kompanisë SPEEEX.

Investim i rëndësishëm nga kjo marrëveshje do të jetë ndërtimi i Qendrës për Kultivimin dhe Grumbullimin e Kërpudhave, Pemëve dhe Perimeve si dhe Qendrës për Trajnimin e Fermerëve Llapjanë.



'KJO NUK ËSHTË ZGJIDHJE, POR NJË MASKARALLËK POLITIK. PROPOZIMI, QË MË SHUMË SESA HAPJE REALE E LISTAVE, DUKET SI DOROVITJE PËR LULËZIM BASHËN'



Nga Bedri ISLAMI

Ka një eufori të habitshme për listat e hapura në zgjedhjet e vitit të ardhshëm, sikur pas tyre gjithçka do të rregullohet, në parlament do të venë më të mirët, më meritoret, aty mendimi do të jetë më i pjekur, nuk do të ketë më gjuzë e belbucë; ende sundon ideja se pas hapjes së listave vullneti i Njëshit do të shembet, populli do të vendosë se kush do të jetë më i votuari, kush do e përfaqësojë; pastaj thirren në përvoja të shteteve të tjera, hapen e mbyllen debate dhe riciklohen ide pa fund, gjithnjë duke i shtruar tezës se vetëm listat e hapura do të sjellin mrekullinë.

Në parim gjithkush është i bindur se listat e hapura, vërtet të hapura, mund të kenë dalim nga ato të mbyllura, ku vetoja për një listë paraprake të vendosur nga shefi i partisë dhe që ishte përlogaritur deri diku saktë se cilët do të ishin deputetët e ardhshëm.

Të gjithë shefat e partive e dinin këtë dhe, si mund të ndodhte, gabimi i tyre ishte i papërfillshëm. Në parlament shkonin ata që donte shefi, që do të përcillnin mesazhet e shefit, do të ngrinin duart kur ua donte shefi dhe nuk do të

kishin asnjëherë mendimin e tyre vetjak. Ndaj, shumë shpejt, ata u kthyen në numra dhe i ikën mendjes.

Largimi nga parlamenti i opozitës, duke e braktisur atë dhe duke i hapur rrugë skalionit të dytë, pra, asaj pjese të listës që ishte sa për të larë gojën, tregoi se përlogaritjet ishin bërë që më herët dhe se pjesa e dytë, ajo që është sot në parlament, është përgjithësisht meskine, e dobët, shpesh herë as që e di pse është aty, përfituese dhe lehtësisht e shtishme.

Tani, këshilli i famshëm politik ka afruar zgjidhjen e fundit: votime me lista të hapura 100 për qind, dhe, duke shkuar pak më tej kësaj, përfaqësuesi i shumicës, Damian Gjijnuri, ka bërë një tjetër propozim, që më shumë duket se si dorovitje për Lulzim Bashën, se sa hapje reale e listave.

Aktualisht ka dy probleme themelore: Së pari, a janë listat e hapura mjeti shpëtimtar nga të gjitha parregullsitë e zgjedhjeve dhe a do të jenë aty vërtet ata që e meritojnë? Oligarkët, biznesmenët, të pasurit, të lidhurit me krimin a do të mund edhe një herë të vetëvendosin që të jenë edhe deputetët e ardhshëm, apo njerëzit do të kërkojnë më të mirën dhe besimi i tyre do të zyrtarizohet?

Pa dashur të heq entuziazmin e parakohshëm, listat e hapura, nëse nuk shoqërohen me mjete të tjera, logjistike, ligjore dhe administrative, ata mbesin po aq pjesë e

korupsionit politik e financiar, si shumë gjëra të tjera në këtë vend.

Në Kosovë, njëri nga shembujt që afrohen me bujë, është e sanksionuar hapja e listave, me koalicionet parazgjedhore, ku forca e parë fituese e zgjedhjeve, pavarësisht nëse është në koalicion apo jo, ka të drejtën e formimit të qeverisë së ardhshme.

Në zgjedhjet e fundit parlamentare, ku listat ishin të hapura, është dashur të bëhet rinumërimi i votave në shumicën e qendrave të votimit të Kosovës.

Të gjithë liderët, pas rinumërimit, kishin më pak vota nga sa kishin pasur në numërimin e parë. Në asnjë rast nuk kishte pasur zvogëlim të votave. Shifrat nganjëherë ishin alarmuese.

Në disa qendra votimi, megjithëse listat ishin të hapura, kishte kandidatë për deputetë që në numërimin e parë dilnin fitues të zgjedhjeve, por që, pas rinumërimit, nuk do e kishin këtë të drejtë.

Kandidatë të tjerë, sidomos zonja, që në numërimin e parë në një qendër votimi nuk kishin pasur asnjë votë, në rinumërim kishin shumicë të ndjeshme, deri edhe dërmuese dhe votat e tyre u kishin kaluar figurave politike sa më afër shefit të partisë.

Në një rast rivotimi të mëhershëm, në Mitrovicë, një kandidat për deputet që në votimin e parë në atë zonë kishte fare pak vota, në rivotim

do të merrte aq shumë, sa i duheshin për të qenë pjesë e parlamentit. Urdhri ishte dhënë nga shefi i partisë.

Nëse nuk ka numërim të sigurt elektronik listat e hapura janë në mëshirën e atyre që paguajnë më shumë ose në direktivën e urdhrat që jep shefi i partisë.

Nëse tani, me listat e mbyllura, kandidatët biznesmenë për deputetë apo të lidhur "me të fortët", në zonën e tyre, shpesh herë i blinin votat me thasë mielli, para në dorë, afrim vende pune etj, tani e kanë më lehtë, ata synojnë të blejnë numëruesit e votave dhe ata nuk kërkojnë shumë.

Këto numërues janë edhe zbatues të vullnetshëm të vendimit të shefit partiak për të deleguar vota aty ku ka synon edhe shefi i partisë. Nëse nuk do të ketë sanksione dhe detyrime ligjore për të gjithë administratën zgjedhore, atëherë listat e hapura janë të hapura për çdo manipulim.

Së dyti, përfaqësuesi i shumicës socialiste në këshillin politik paraqiti një draft, përmes së cilit e gjithë loja me lista të hapura kthehet në mbylljen e tyre, por tashmë ligjore.

Sipas draftit, shefi i partisë, cilido qoftë ai, ka të drejtën e renditjes së listës për kandidatë. Natyrisht do të vendosë më besnikët ndaj tij dhe në rastin e opozitës do të jenë aty edhe vemjet politike të partiçkave që iu veshën forcave të mëdha politike, ndërsa forcat e reja do i kenë portat e mbyllura.

Nëse votuesi ka të drejtën të përzgjedhë vetëm një kandidat, atëherë në shumësinë e rasteve ai është shefi i partisë ose i deleguari i qendrës. Nuk bëhet ndryshe, pasi secila forcë synon që shefi i saj të jetë njeriu më i votuar.

Në Kosovë ke të drejtën për të zgjedhur pesë kandidatë nga lista dhe kjo e bën më të hapur listën. Më të vështirë, por më të hapur.

Nëse në një qark, të themi Shkodër, për të qenë deputet do të kërkohen rreth 10 mijë vota, duke pasur të drejtën e një përzgjedhje, asnjë nga kandidatët nuk e arrin këtë shifër dhe mbetet përsëri lista e shefit të partisë.

Kjo nuk është zgjidhje. Është një maskarallëk politik, që, duke i hapur rrugë Bashës të bëjë lojën e tij politike, hedh në erë gjithçka që mendohet se mund të jetë e dobishme.

Listat e hapura, përmes këtij drafti, mbyllen dhe e gjithë loja kthehet përsëri në tryezat e shefave, të cilët, kanë ende të drejtën të vendosin se kush do të jetë në parlament.

Askujt nuk i intereson halli i Bashës apo i Kryemadhit dhe fati i tyre vetjak në këto zgjedhje; themelore është të futen ato rregulla që sanksionojnë hapjen e listave dhe përzgjedhjen deri diku të atyre që e meritojnë.

Rikthimi në pikën zero është humbje e demokracisë thelbësore, fshehje pas Njëshit dhe pas një liste që mbetet po ajo që ishte dhe që nuk ndryshon asgjë.

Përfundojnë punimet për restaurimin e hambarit të familjes Jonuzaj në fshatin Senik të Malishevës

MALISHEVË, 23 SHTATOR (ER) - Ndërtimi i këtij hambari është realizuar në vitet '30 të shekullit të kaluar. Marrë për bazë faktin se hambari i familjes Jonuzaj është ndër ata të cilët kanë ngelur në të trevën e Llapushës, është i veçantë në radhë të parë për vjetërsinë, funksionin, punën karakteristike gdhendur në dru, por edhe gjendjen e mirë që ka si rezultat i kujdesit të vazhdueshëm të familjes. Përndryshe, sipas familjarëve të familjes Jonuzaj, hambari nuk është përdorur që një kohë të gjatë për funksionin se për çfarë ishte dedikuar në kohën e ndërtimit por ai, megjithatë,

mbetet vlerë e shtuar e paraqitjes së mënyrës së jetesës si dhe simbol i begatisë në familjet fshatare të vendit tonë. Samir Hoxha, drejtor në Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturorë në Prizren, thotë se, bazuar në përkushtimet e këtij institucioni për identifikimin, dokumentimin dhe inventarizimin e trashëgimisë kulturore për rajonin, respektivisht territorin e Komunës së Prizrenit, janë evidentuar shumë objekte me vlerë që janë dëshmi se kjo anë është e pasur edhe me këtë lloj trashëgimie.



Pablo Neruda: Pse e shkrova poezinë për Stalinin

Shumë njerëz kanë menduar se jam ose kam qenë një politikan i rëndësishëm. S'e di si nisi të përhapem kjo legjendë e famshme. Një ditë sinqerisht u çudita kur pashë foton time, të vogël sa një pullë poste, tek dy faqëshi i revistës Life, ku paraqiteshin udhëheqësit e komunizmit botëror, si diçka e dobishme për lexuesit e saj. Prania ime, e ngecur diku midis Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Komuniste të Brazilit Louis Carlos Prestes dhe Mao Ce Dunit, m'u duk shaka argëtuese, por s'i shkrova askujt për ta bindur se kjo s'ishte e vërtetë, sepse gjithmonë i kam urryer letrat ku duhet të shpjegohesh. Përveç kësaj, ishte argëtuese të shihje CIA-n ta bënte këtë gabim pavarësisht pesë milion agentëve që ka në të gjithë botën.

Kontakti më i gjatë që kam mbajtur me ndonjë nga figurat kryesore të socializmit botëror ishte gjatë vizitës tonë në Pekin. Kishte të bënte me një dolli që piva me Mao Ce Dunin gjatë një ceremonie. Ndërsa gotat tona u cekën, ai më shikoi me sy të qeshur dhe një buzëqeshje të gjerë gjysmë miqësore dhe gjysmë ironike. Ma mbajti dorën tek e tija, duke e shtrënguar disa sekonda më shumë se zakonisht. Pastaj u kthye në tryezën ku ishte ulur më parë.

Në shumë vizita ime në Bashkimin Sovjetik nuk kam parë as Molotovin, as Vishinsky-n dhe as Berian; madje as Mikoyan apo Litvinovin, i cili ishte më i shoqërueshëm dhe më pak misterioz se të tjerët.

E kam parë Stalinin në largësi, më shumë se një herë, gjithmonë në të njëjtin vend: në tribunën e ngritur në Sheshin e Kuq, i cili mbushej me

udhëheqës të nivelit të lartë çdo vit në 1 maj dhe 7 nëntor. Kam kaluar shumë orë në Kremlin, si pjesë e jurisë për çmimet që mbanin emrin e Stalinin, pa e takuar kurrë atë, madje as në ndonjë korridor. Ai kurrë s'erdhi të na takonte gjatë seancave ose drekave tona të votimit, dhe kurrë s'na kishte thirrur as për një fjalë përshëndetëse. Çmimet jepeshin gjithnjë unanimisht, por kishte raste kur debati për zgjedhjen e kandidatit fitues ishte shumë i nxehtë. Gjithmonë kisha ndjesinë se, para se të merrej vendimi përfundimtar, dikush nga paneli i jurisë nxitonte me përfundimin e mundshëm të votimit për tek njeriu i madh për të parë nëse fituesi kishte bekimin e tij. Por me të vërtetë s'mund të kujtoj një herë të vetme kur kemi pasur ndonjë kundërshtim prej tij, dhe megjithëse ishte e dukshme se ishte afër, s'më kujtohet se e kishte kërkuar ndonjëherë praninë tonë atje. Pa dyshim, Stalini kultivoi në mënyrë sistematike misterin për të, ose duhet të ketë qenë jashtëzakonisht i ndrojtur, një njeri që ishte i burgosuri i vetes. Ka gjasa që ky tipar të ketë të bëjë shumë me ndikimin e fortë që Beria kishte tek ai. Beria ishte i vetmi që hynte dhe dilte pa paralajmëruar nga dhomat e Stalinin.

Sidoqoftë, në një rast pata një takim të papritur me njeriun misterioz të Kremlinit i cili edhe tani më duket i jashtëzakonshëm. Aragonët, Luisi dhe Elsa, dhe unë ishim rrugës për në Kremlin për të marrë pjesë në takimin që do të përcaktonte Çmimet Stalin për atë vit. Stuhitë e mëdha të dëborës na detyruan të ndalemi në Varshavë. Nuk do të arrinim



dot në kohë në takimin tonë. Një nga rusët telefonoi në Moskë, foli në rusisht, dhe dha emrat e kandidatëve që unë dhe Aragon favorizonim, të cilët, meqë ra fjala, u miratuan në takim. Por e çuditshmja në lidhje me këtë është se rusi, i cili mori një përgjigje përmes telefonit, më thirri mënjandhe dhe më befasoi duke më thënë, "Të përgëzoj, shoku Neruda. Kur lista e fituesve të mundshëm të çmimit iu dha shokut Stalin, ai bërtiti: "Po emri i Nerudës pse s'është mes tyre?"

Vitin tjetër, mora Çmimin Stalin për Paqe dhe Miqësi midis Popujve. Mbase e kam merituar, por prapë pyes veten se si ai njeri i tërhequr zbuloi ndonjëherë që unë ekzistoj. Kam dëgjuar për ndërhyrje të tjera të ngjashme nga Stalini në atë kohë. Kur fushata kundër kozmopolitizmit po shtohet dhe bëhet gjithnjë e më e madhe dhe fanatikët e kollarisur kërkonin kokën e Ehrenburgut, një mëngjes ra telefoni në shtëpinë e autorit të Julio Jurenito, Ilia Ehrenburg. U përgjigj Ljuba. Një zë që ngjante si i njohur pyeti: "A është Ilia Gregorieviç aty?"

– Kjo varet, – u përgjigj Ljuba. – Kush jeni ju?

– Jam Stalini, – tha zëri.

– Për ty, Ilia, një shakaxhi, – i tha Ljuba Ehrenburgut.

Por kur mori telefonin, shkrimtari e dalloj zërin e njohur të Stalinin:

– E kalova natën duke lexuar librin tënd Rënia e Parisit. Po të telefonoj për të të thënë të vazhdosh të shkruash libra po aq interesant sa ky, i dashur Ilia Gregorieviç.

Ndoshta ajo telefonatë e papritur bëri të mundur jetën e

gjatë të Ehrenburgut të madh.


Një rast tjetër: Majakovski tashmë kishte vdekur, por armiqte e tij kokëfortë e sulmonin në mënyrën më të egër kujtimin e poetit, të vendosur për ta fshirë nga harta e letërsisë sovjetike. Pastaj ndodhi diçka që i prishi këto plane. E dashura e tij Lili Brik i shkruajti një letër Stalinin duke i treguar se sa të turpshme ishin këto sulme dhe mbrojti me pasion poezinë e Majakovskit. Sulmuesit e tij, të cilët mendonin se ishin të paprekshëm, të mbrojtur nga mediokriteti i tyre kolektiv, ishin duke kryer goditjen e tyre më të ashpër. Në cep të letrës së Lili Brik, Stalini la shënimin: "Majakovski është poeti më i mirë i epokës sovjetike". Pas kësaj u ngritën muze dhe monumente për nder të Majakovskit dhe shumë libra me poezisë e tij të jashtëzakonshme u botuan. Kundërshtarët e tij ngrinë, u goditën dhe ishin të pafuqishëm pas gjëmimit të borisë së Jehovait.


Mësova gjithashtu se midis letrave të Stalinin të gjetura pas vdekjes së tij kishte një listë ku shkruhej: "Të mos preken", në dorëshkrimin e tij. Kjo listë kishte në fillim emrin e kompozitorit Shostakoviç, pasuar nga emra të tjerë të shquar: Sergei Eisenstein, Pasternak, Ehrenburg, etj. Shumë njerëz kanë besuar se jam një stalinist i pandryshueshëm. Fashistët dhe reaksionarët më kanë përshkruar si një interpretues lirik i Stalinin. Kjo nuk më bën përshtypje të veçantë. Çdo lloj gjykimi është i mundur për një epokë djallëzish të pështjelluar. Tragjedia vetjake për ne komunistët ishte të përballëshim me faktin se, për disa aspekte të çështjes së

Stalinin, armiku kishte të drejtë. Kjo zbulesë, e cila ishte marramendëse, na la në një gjendje të dhimbshme shpirtërore. Disa u ndjenë të mashtruar. Të dëshpëruar, ata pranuan arsyetimin e armikut dhe kaluan në anën e tij. Të tjerët besuan se faktet tronditëse, që dolën në dritë në mënyrë shqetësuese gjatë Kongresit të Njëzetë, provuan integritetin e një Partie Komuniste e cila mbijetoi, duke e lënë botën të shihte të vërtetën historike dhe duke pranuar përgjegjësinë e vet. Nëse është e vërtetë që të gjithë e kemi të përbashkët këtë përgjegjësi, akti i denoncimit të atyre krimeve na çoi përsëri në autokritikë dhe analiza, elemente thelbësore për doktrinën tonë dhe na dha armët e nevojshme për të parandaluar që gjëra të tilla të tmerrshme të ndodhin përsëri. Ky ishte qëndrimi im: mbi këtë errësirë që ishte e panjohur për mua gjatë epokës së Stalinin, ai u ngrit para syve të mi, si njeri me zemër të mirë, me parime, i matur, si vetmitar, mbrojtës titan i Revolucionit Rus. Për më tepër, ky njeri i vogël me mustaqe të mëdha ishte kthyer në një gjigant gjatë kohës së luftës. Me emrin e tij në buzë, Ushtria e Kuqe sulmoi dhe shkatërroi fuqinë e demonëve të Hitlerit. E megjithatë i kushtova vetëm një nga poezitë e mia këtij personaliteti të fuqishëm. Ishte me rastin e vdekjes. Çdokush mund ta gjejë në përmbledhjet e veprave të mia. Vdekja e Ciklopit të Kremlinit pati ndikim në të gjithë botën. Xhungla njerëzore u drodh. Poezia ime kapi ndjenjën e këtij paniku në tokë.

Shkëputur nga *Kujtime*, Penguin Books, 1992.

Përktheu: Granit Zela / exlibris.al





EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Ministrja Dumoshi: Pakoja emergjente do të dedikohet edhe për sport

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Në Prishtinë ka filluar Java Evropiane e Sportit që do të zgjasë deri më 30 shtator. Në ditën e parë, organizuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) dhe Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK), është organizuar "Forumi për Sportin". Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë Vlora Dumoshi, ministre e MKRS-së, Armend Zemaj, ministër i Shëndetësisë, Besim Hasani, kryetar i KOK-ut, si dhe përfaqësues të tjerë nga federatat sportive, por edhe të Departamentit të Sportit, derisa Federatën e Basketbollit të Kosovës (FBK) e përfaqësuan kryetari Arben Fetahu dhe sekretarja e përgjithshme, Elvira Dushku. Në temën "Sporti dhe Covid-19" është folur për ndihmën që kanë nevojë federatat dhe klubet sportive. "Pakoja emergjente e ndarë nga Qeveria Hoti do të dedikohet për klubet, pasi jemi të vetëdijshëm që bizneset nuk kanë mundur të ndihmojnë klubet gjatë pandemisë. Do të

bisedojmë bashkë me kryetarin e KOK-ut, Besim Hasani dhe federatat sportive, për kriteret dhe mënyrën e ndarjes së tyre. Ligji për Pakon Emergjente është dërguar tri herë në Kuvendin e Kosovës, por nuk është miratuar nga deputetët. Sigurisht se kur të miratohet do t'i ndihmojmë federatat dhe klubet", ka thënë ministrja Dumoshi gjatë pjesëmarrjes në "Forumit e Sportit" që hapi Javën Evropiane të Sportit. Ajo kishte edhe një falënderim në këtë forum. "Falënderoj Federatën e Basketbollit, që së bashku me Federatën Shqiptare të Basketbollit kanë formuar Ligën Unike. Kështu iniciativa duhet të ndërmarrin edhe federatat e tjera, sidomos në këtë kohë të pandemisë, kur ka më pak aktivitete sportive", ka shtuar Dumoshi, e cila ka kërkuar që të ndihmohen më shumë edhe klubet e femrave. Ministrja Dumoshi bëri me dije se përkrahja e MKRS-së për sportin në kohë pandemie është bërë me një kujdes të veçantë.



"Prioritet i MKRS-së edhe këtë vit janë investimet që janë duke u realizuar në modernizimin e infrastrukturës sportive. Këto investime kalojnë shumën e 19 milionë eurove në mbi 80 projekte infrastrukturore, në të gjitha komunat e Kosovës, duke u realizuar në stadione, palestra, fusha të tenisit, pishina, poligone sportive, shtigje të atletikës, ku përfitues janë edhe komunat e

komuniteteve dhe tërë këto investime të MKRS-së ndikon edhe në masivizimin e sportit në përbushje të objektivit "Sport për të gjithë", ka shtuar ajo. Ndërsa ministri Zemaj theksoi se pritet që të ketë lehtësim të masave sa i përket zhvillimit të ngjarjeve sportive. "Do të kemi lehtësim të masave në disa aktivitete sportive, të cilat janë të domosdoshme në numër dhe

masë. Ne do të kemi mbikëqyrje strikte, bazuar edhe në zotimin që kemi marrë nga Komiteti Olimpik i Kosovës dhe federatat sportive. Nuk do të doja që asnjë federatë të mbyllet për shkak të mosrespektimit të masave. Disa ngjarje ndërkombëtare janë zhvilluar si ndeshja Kosovë - Greqi në futboll te meshkujt apo Kosovë - Estoni te femrat, por të gjitha janë bërë me rekomandime, por edhe një mbikëqyrje të madhe", ka thënë ministri i Shëndetësisë. Besim Hasani, kryetar i KOK-ut, foli për qëllimin e mbajtjes së këtij Forumi. "Qëllimi i Javës Evropiane është që sa më shumë njerëz të merren me sport, andaj marrë parasysh numrin e vogël që merren me sport, duhet të fokusohemi që sa më shumë fëmijë të merren me sport. Prindërit, vëllezërit, motrat dhe gjyshërit duhet t'i marrin fëmijët për t'i regjistruar në ndonjë prej klubeve të komunave të tyre në Kosovë, ashtu siç i marrin për t'i dërguar në shkollë", ka deklaruar Hasani.

Ballkani fiton derbin ndaj 'Niklit', Gjilani shijon fitoren e parë



PRISHTINË, 23 SHTATOR (ER) - Skuadra e Ballkanit e ka nisur në mënyrë më të mirë kampionatin 2020/2021 në Superligë pasi e ka regjistruar edhe fitoren e dytë. Skuadra e Ismet Munishit e fitoi derbin ndaj Feronikelit, pasi e mposhti me rezultat 3-2. Futbollisti Mirlind Daku, ashtu sikurse në xhiron e parë, edhe në këtë ndeshje realizoi tre gola. Sulmuesi shtatlartë dy gola i realizoi në pjesën e parë dhe një gol në pjesën e dytë, ndërsa skuadra e Afrim Tovërlanit pesë minuta para fundit të ndeshjes shënoi golin e parë të ndeshjes, pasi Marclei shënoi për 3-1. I njëjti futbollist në minutën e 88 realizoi edhe golin e dytë dhe të fundit të ndeshjes. Gjilani e ka

harruar humbjen që pësoi në xhiron e parë dhe arriti që t'i marrë tri pikë të plota në ndeshjen ndaj Llapin në "Zahir Pajaziti", pasi fitoi me rezultat 0-1. Pjesa e parë u mbyll pa gola, kurse në fillim të pjesës së dytë Fiton Hajdari dështoi të shënojë nga penalltia. Në minutën e 62-të, Nikaq realizoi golin e fitores për gjilanasit. Kjo është ndeshja e parë për Llapin në këtë edicion, pasi në ndeshjen e parë pushoi për shkak se Drita luan në Ligën e Evropës. Ndërsa ndeshja në mes të Dritës dhe Trepçës '89 zhvillohet më vonë për shkak se kampionët e Kosovës në raundin e tretë parakualifikues të Ligës së Evropës sonte (e enjte) do të përballen me Legian.

Drejtuesit e FFK-së takohen me Thierry Favre

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Delegacioni i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), në krye me kryetarin Agim Ademi, anëtarin e KE-s, Mirsad Çollaku dhe sekretarin e Përgjithshëm Eroll Salihu, kanë arritur në Budapest, ku po qëndrojnë me ftesë të presidentit të UEFA-s, Aleksander Čeferin

dhe do ta ndjekin nga afër ndeshjen e Superkupës së Evropës ndërmjet Bayernit dhe Sevillas që zhvillohet të enjten në orën 21:00. Me të arritur në Budapest drejtuesit e FFK-së janë takuar me zëvendës drejtorin e asociacioneve kombëtare, njëherësh drejtuesin e programit 'HatTrick',

Thierry Favre, e ku ishte i pranishëm edhe menaxheri i programit 'HatTrick', Denis Bastari. "Në këtë takim u bisedua për gjendjen dhe ecurinë e projekteve të FFK-së në kuadër të këtij programi, me ç'rast zyrtarët e UEFA-s u shprehën të kënaqur me punën e bërë sidomos në për-

mirësimin e infrastrukturës. Po ashtu, ata u shprehën të lumtur që tashmë edhe në Kosovë ka filluar të rrokulliset topi në fushën e gjelbër dhe përgëzuan drejtuesit e FFK-së për menaxhimin të mirë të situatës së pandemisë", thuhet në njoftimin e



FFK-së. Drejtuesit e FFK-së do të marrin pjesë edhe në takimin që UEFA do ta mbajë me 55 federatat anëtare.

John: Isha i pafat ndaj Arbërisë

PRISHTINË, 23 SHKURT - Sulmuesi i FC Prishtina, Oto John, e ka konsideruar veten të pafat në ndeshjen ndaj Arbërisë (1-1), pasi humbi disa raste shënimi. Sulmuesi në fjalë e shënoi golin e barazimit, por ai

është i bindur se e ka merituar të shënojë edhe gola të tjerë. "Ishte ndeshje zhgënjyese, sepse ne i patëm mundësitë ta fitonim ndeshjen, por ky është futbollli. Ende kemi shumë ndeshje për të zhvilluar dhe

kemi pikë për të marrë dhe duhet të përqendrohemi për ndeshjet e radhës. Është e vërtetë që përveç golit, pata edhe tri tentime të tjera drejt portës por, isha i pafat, shpresoj që në të ardhmen të jem edhe më

efikas. Po ashtu, jam i lumtur që e nisa sezonin me gola dhe shpresoj të shënoj sa më shumë gola të tjerë për të ndihmuar ekipin t'i arrijë qëllimet që i ka ekipi ynë", ka thënë John për faqen zyrtare të Prishtinës.



Ndërron jetë ish-kryetari i Gjilanit, Shukri Sylejmani



GJILAN, 23 SHTATOR - Ka ndërruar jetë ish-kryetari dhe donatori kryesor i skuadrës së Gjilanit, Shukri Sylejmani. Që prej themelimit të këtij klubi, më 1995, e deri disa vite të pasluftës, Sylejmani ka qenë kryetar dhe donatori kryesor i SC Gjilani. Dekani i Fakultetit të Edukatës Fizike dhe Sportit në Universitetin e Prishtinës, Musa Selimi, e ka kujtuar Sylejmanin, duke thënë se emri i tij është shkruar me shkronja të arta në futbollin e Kosovës. "Paska ikur kryetari Shukri Sylejmani. Emri i tij është i shkruar me shkronja të arta në futbollin e Kosovës.

Gjilani humbi njeriun e sportit e jo vetëm! Lavdi deri në përjetësi jetës dhe veprës tënde! Pusho i qetë kryetar!", ka shkruar Selimi në profilin e vet në "Facebook". Familjen Sylejmani e ka kujtuar edhe kryetari i FFK-së, Agim Ademi. "Fjalët janë të pakta për ta nderuar tërë atë që Shuki bëri për futbollin, andaj në këtë ditë pikëlluese të ndarjes së tij nga ne, në emrin tim, të KE të FFK-së dhe tërë komunitetit të futbollit i shpreh ngushëllimet e mia më të sinqerta familjes së të ndjerit, miqve të tij të shumtë dhe SC 'Gjilani' për humbjen e

këtij njeriu të madh, i cili do të kujtohet gjithmonë për veprën e tij madhështore në mbajtjen gjallë dhe zhvillimin e mëtejshëm të futbollit të Kosovës", ka thënë Ademi. Përndryshe, Shukri Sylejmani, me iniciativë të Lutfi Hazirit, vitin e kaluar është nderuar me titullin "Nderi i Qytetit" nga Kuvendi Komunal, me motivacionin për kontribut të jashtëzakonshëm në themelimin dhe donacionin për SC Gjilani, duke e formuar në kohën kur shteti i Serbisë i kishte shkatërruar çdo gjë popullit të Kosovës.

Deneveri mposhti Lakersat, rihapet beteja për titull

ORLANDO, 23 SHTATOR - Denveri fitoi me rezultat 114-106 ndaj Lakersit në finalen e tretë të "play-off"-it në Konferencën e Perëndimit, duke rihapur garën për titullin kampion. Tashmë Lakersi udhëheq 2-1 me ndeshje, ndërkohë që po 2-1 udhëheq edhe Miami ndaj Bostonit në Lindje. Sfida e tretë mes Lakersave dhe Denverit u dominua shumicën e kohës nga Nuggets, që u shkëput deri në 20 pikë në periodën e katërt. Në fund, Lakersat tentuan të befasojnë por, pa sukses. Murray realizoi 28 pikë e 12 asistime për Denverin, mbështetur nga Grant me 26 pikë e Jokiqi me 22 pikë e 10 rebounde, një trio që bëri diferencën në parket. Për Lakersat, LeBron James e Davis realizuan 57 pikë së bashku, të pambështetur si duhet nga pjesa tjetër e ekipit.



SHKURT

Voca paraqitet tek Ankaragucu

Futbollisti i Përfaqësueses së Kosovës në Futboll, Idriz Voca, është paraqitur te skuadra e Ankaragucu. Voca pas 12 vjetësh qëndrimi në Luzren, ka vendosur të nisë një aventurë të re. Është skuadra nga Superliga e Turqisë, Ankaragucu, që ka siguruar shërbimet e 23-vjeçarit. Ankaragucu sezonin e kaluar në Superligën e Turqisë ka përfunduar në vendin e fundit, por federata e këtij vendi ka vendosur që asnjë skuadër të mos bjerë nga kategoria.

Gjykata në Zvicër kërkon 28 muaj burgim për presidentin e PSG-së

Edhe pse dy fitoret radhazi në Ligën 1 qetësuan disi situatën, sërish PSG-ja nuk gjen paqe. Tashmë në shënjestër është bërë presidenti i kampionëve të Francës, Nasser Al-Khelaifi, i cili mund të përfundojë në burg. Sipas agjencisë së lajmeve "Keystone ATS", drejtësia zvicerane ka kërkuar 28 muaj burgim për Al-Khelaifi, pasi akuzohet për ryshfet. Al-Khelaifi, gjithashtu, president i "BeIN Media", akuzohet për ryshfet ndaj Jerome Valcke, ish-nënkryetar i FIFA-s, për t'i marrë të drejtat televizive të Kupave të Botës 2026 dhe 2030. Ndërkohë për Valcke është kërkuar një burgim prej tre vjetësh. Gjyqi për këtë çështje nisi disa muaj më parë në Gjykatën Federale Penale në Bellinzona të Zvicrës, ndërsa vendimi pritet të dalë më 30 tetor.

Semedo transferohet te Wolverhamptoni

Barcelona ka konfirmuar arritjen e marrëveshjes me Wolverhamptonin, që Nelson Semedo të transferohet në Premierë Ligë. Wolverhamptoni do të paguajë 30 milionë euro për Semedo, kurse në marrëveshjen mes palëve janë përfshirë disa klauzola që Barcelonës i japin edhe 10 milion euro të tjera në formë shpërblimesh. Në vitin 2017 mbrojtësi i djathtë ishte transferuar në "Camp Nou" nga Benfica.

Flick e dëshiron Gotzen në Bayern

Trajneri i Hansi Flick e dëshiron në skuadër Mario Gotzen, i cili në të kaluarën ka qenë pjesë e Bayernit, por që nuk arriti të dëshmojë dhe vendosi të rikthehet në Borussia Dortmund. Flick dhe Gotze kanë histori të mirë së bashku, pasi e fituan Kupën e Botës me Gjermaninë në vitin 2014. Aktualisht Mario Gotze është lojtar i lirë pas mbarimit të kontratës së tij me Dortmundin. Nga Bayerni janë larguar Coutinho, Thiago, Perisic dhe Odriozola, por mund të largohen edhe Martinez dhe Alaba.

UEFA zbulon kandidatët për lojtarin dhe trajnerin më të mirë

UEFA ka publikuar kandidatët finalë për çmimet e sezonit 2019-2020 në kompeticionet e klubeve. Kapiteni i kampionëve të Evropës (Bayern), Manuel Neuer, sulmuesi Robert Lewandowski dhe mesfushori i Manchester City, Kevin De Bruyne, do të konkurrojnë për "Çmimin e lojtarit më të mirë të UEFA-s", për sezonin që lamë pas.

Ndërkohë që vlerësimi për "Trajnerin më të mirë të UEFA-s" do të shkojë në Gjermani teksa konkurrojnë me 3 trajnerë nga i njëjti vend: Jurgen Klopp (Liverpool), Hans-Dieter Flick (Bayern Munchen) dhe tekniku i Lajpcigut, Jurgen Nagelsman. Ceremonia do të mbahet më 1 tetor, kur do të hidhet dhe shorti për ndarjen e grupeve të Ligës së Kampionëve. Asnjë lojtar nga nënkampionët e Evropës, PSG-ja apo dhe Lyoni që shkoi deri në gjysmëfinale të kompeticionit nuk është vlerësuar për çmimin final. Pritet që të dyja çmimet të fitohen nga Bayerni pas një sezoni fantastik të realizuar duke fituar "tripletën" për herën e dytë në historinë e tij. Për herë të parë që prej vitit 2010, dy superyjet e futbollit Cristiano Ronaldo dhe Lionel Messi nuk nominohen për këtë çmim.



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
 Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine
 Ministry of Economy and Environment

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë
 për Kushtet Ndërtimore**

“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.**

Nr. prot: 3517/20 të datës 30.07.2020, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

Posta rekomande:

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
 Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
 Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
 Ndërtesa e Rilindjes
 Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku i mëposhtëm:

<http://mmp-h-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor

Suzana.goranci@rks-gov.net

Telefon: + 381 38 200 32 553

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “KEPE”, SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 810068529, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo “KEPE”, D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nr. 810068529, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “KEPE”, L.L.C.. has come to the decision to quit its nr. 810068529, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Lume's Details
 Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
 Sallon Depilimi Lume's Details
 lumesdetails
 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731

► Armend Kabashi shpall të pavlefshme dëftesat e klasës së -I- deri -IX- të shkollës fillore “Lekë Dukagjini” në Prizren.

► Mirella Fejza shpall të pavlefshëm dëftesat e klasës -I- deri -IX- të shkollës fillore “Lekë Dukagjini” në Prizren.

► Gënitrit Llapqeva shpall të pavlefshme dëftesat e klasës së X, XI, të shkollës së mesme “Lorenc Antoni” në Prizren.

► Viola Behra shpall të pavlefshme dëftesat e klasës së -I-V, të shkollës fillore “Bajram Curri” Krushë e Madhe, Prizren.

► N.P.T. Shpendi-B, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70168591 Prishtinë.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA E ARSIMIT

Nr-4- **411-46103**

Datë: 23.09.2020

Në bazë të nenit 16 dhe 62 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040, Ligjit të punës Nr 03/L-212, Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, neni 5 pika C, Statutit të Komunës së Lipjanit, U.A Nr. 10/2018 (MASHT) dhe U.A Nr. 07/2017 (MPMS), Drejtoria Komonale e Arsimit në Lipjan rishpall:

KONKURS

Konkurs për plotësimin e listës rezervë me mesimdhënës/e për profilet:

- I. Parashkolloret 5 pozita;
- II. Programi fillor 30 pozita;
- III. Gjuhë Shqipe 6 pozita;
- IV. Gjuhë Angleze 3 pozita;
- V. Gjuhë Gjermane 2 pozita;
- VI. Matematikë 5 pozita;
- VII. Fizikë 2 pozita;
- VIII. Kimi 2 pozita;
- IX. Biologji 2 pozita;
- X. Histori 2 pozita;
- XI. Gjeografi 2 pozita;
- XII. Ed. Qytetare 2 pozita;
- XIII. TIK 2 pozita;
- XIV. Elektro 1 pozitë;
- XV. Bujqësi 1 Pozitë;
- XVI. Makineri 1 pozita;

Kushtet e kërkuara:

- Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:
 - Aplikacioni i plotësuar (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë sporteli nr. 3);
 - Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
 - Diplomë (Çertifikatë) fotokopje të vërtetuar nga organi përkatës
 - Certifikata që nuk jeni nën hetime.
 - Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

Kriteret e kualifikimit:

Përgatitje adekuate profesionale, në bazë të normativit 10/2018 (MASHT), Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Si informata të sakta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë të nostrifikuar diplomat nga MASHT.

Për intervistë do të ftohet ata kandidat të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të lartcekura.

Informimi i kandidatëve aplikues rreth mbajtjes së testit me shkrim, intervistës me gojë dhe shpallja e rezultateve do të bëhet në Web faqen e Komunës së Lipjanit <https://kk.rks-gov.net/lipjan/> dhe në tabelën e shpalljeve.

Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë do të jetë në varësi të rasteve vakante në shkolla si dhe rasteve të mesimdhënësve me probleme shëndetësore që paraqiten gjatë vitit shkollor 2020/2021.

Konkursi mbetet i hapur 7 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit.

Dokumentet e pranuar nuk kthehen.

Drejtoresha e DKA-së
Elnaze Behluli

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2019:298732
Datë: 21.08.2020
Numri i dokumentit: 01073017

C.nr.472/2019

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, i përbërë nga gjyqtari i vetëm **Betim Behluli**, në çështjen juridike të paditësit Sahit Selim Qehaja nga fshati Reti e Poshtme, Komuna e Rahovecit, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar avokati Myhedin Bekeri nga Rahoveci, kundër të paditurit Milan Xhorxha Trifunovic fshati Reti e Epërme, Komuna e Rahovecit, tani gjendet me adresë të pa njohur, për shkak të vërtetimit të pronësisë në bazë të fitimit me parashkrim, vlera e kontestit 1.000 Euro, me dt.21.08.2020, merr këtë:

A K T V E N D I M

Të paditurit Milan Xhorxha Trifunovic fshati Reti e Epërme, Komuna e Rahovecit, tani i shpërngulur me adresë të pa njohur, I CAKTOHET përfaqësuesi i përkohshëm avokat Gazmend Sharku nga Rahoveci.

Në kuptim të nenit 82 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor, të cilat i ushtron deri sa të paraqitet në gjykatë i padituri apo përfaqësuesi i tij me prokurë, gjegjësisht derisa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Ky aktvendim do të shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në një nga gazetatat e përditshme ditore, si dhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës.

A r s y e t i m

Paditësi Sahit Selim Qehaja nga fshati Reti e Poshtme, Komuna e Rahovecit, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar avokati Myhedin Bekeri nga Rahoveci, ka ushtruar padi për vërtetimin e pronësisë në bazë të fitimit me parashkrim, kundër të paditurit Milan Xhorxha Trifunovic fshati Reti e Epërme, Komuna e Rahovecit, tani gjendet me adresë të pa njohur.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të padisë ka vërejtur se i padituri është shpërngulur dhe përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ka propozuar që në këtë çështje kontestimore të caktojë një përfaqësues të përkohshëm që i njëjti t'ia mbrojë të drejtat deri sa të paraqitet në gjykatë vetë i padituri respektivisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftojë gjykatën për caktimin e kujdestarit.

Duke vendosur sipas propozimit të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, gjykata gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 79.3 të LPK-së, për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurit dhe se përfaqësuesi i përkohshëm av. Gazmend Sharku nga Rahoveci, është pajtuar që ta përfaqësojë të paditurin e lartcekur në këtë çështje juridiko - civile.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC,
C.nr.472/2019, me datë 21.08.2020

Gjyqtari
Betim Behluli

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate, për



Gjeje PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejepuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

Në 22 vjetorin e rënies heroike të bashkëshortit dhe babait tonë të shtrenjtë



MUSTAFË (Shaqir) SHYTI

(10.10.1945- 24.09.1998)

Vitet po ikin e ne po jetojmë me dhimbjen, mallin, kujtimin por edhe madhëstinë Tënde.

Me mall dhe dashuri të përjetshme!

Bashkëshortja Elhemja, fëmijët: Vjollca, Berati, Merita, Jehona, Kushtrimi e Saranda dhe Familja Shyti.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

